

V E N D I M
Nr. 59, datë 23.1.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 415, DATË 1.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT “PËR MUNDËSI TË
BARABARTA”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.127, DATË 15.3.2001”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr. 8485, dsatë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 415, datë 1.7.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Komiteti “Për mundësi të barabarta” është institucion qendror, në varësi të Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, që funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar nga Ministri.”.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Kryetari i komitetit “Për mundësi të barabarta”, emërohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, ndërsa struktura dhe organika e komitetit caktohen nga Kryeministri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano